



Pranuar / Dorëzuar Prilijeno / Prodato Received / Delivered	17.08.2023	3	viii god vepr.
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEMUSHOK	5704/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.904/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.904/2023 të datës 04.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë rruga [redacted] në Komunën e Vushtrrisë, kundër Vendimit me numër protokolli 25281/23 të datës 09.06.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.904/2023 e datës 04.07.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 25281/23 i datës 09.06.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë më datë 22.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00011261 për grupin Specialist të Psikologjisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike", ku afati për aplikim ka qenë nga data 12.04.2023 deri më datë 26.04.2023.

Në këto konkurse ka aplikuar edhe ankuesja, e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak ndërsa është ftuar të marr pjesë në testin me shkrim, ku në bazë të rezultatit në testin me

shkrim ka marr 42 pikë, ndërsa në vlerësim të jetëshkrimit ka marr 20 pikë, çka nënkupton se nga këto dy faza ka marr gjithsej 62 pikë të mjaftueshme për të kaluar në fazën e intervistës me gojë.

Përmes sistemit SIMBNJ, më datë 29.05.2023 ankuesja është njoftuar se nga komisioni ka marr 20 pikë dhe në bazë të kësaj ju kaloni në fazën tjetër të vlerësimit të kandidatëve duke e udhëzuar që të vizitoni linkun si në email, dhe njoftimi rrjedh për datë 31.05.2023 ditë e mërkurë në orën 10:00 në sallën e rekrutimeve Nr. 16, kati i Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina" në Vushtri.

Ankuesja nuk ka marr pjesë në fazën e intervistës me gojë, ndërsa sipas Renditjes përfundimtare të kandidatëve të publikuar më datë 31.05.2023 rezulton se ankuesja përveç 62 pikëve të marra në dy fazat paraprake, në fazën e intervistës me gojë ka marr zero (0) pikë dhe është renditur e katërta në këtë renditje përfundimtare, ndërsa sipas njoftimit për rezultatet e vlerësimit të datës 01.06.2023 palëve të pakënaqura me vlerësimin i është dhënë mundësi për ankesë në afat prej tri ditësh.

Ankuesja më datë 01.06.2023, ndaj këtij vlerësimi ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit në Komunën e Vushtrrisë. Komisioni i Pranimit në Komunën e Vushtrrisë më datë 09.06.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 25281/23 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi rezultatet përfundimtare të vlerësimit.

Ankuesja, kundër Vendimit me numër protokolli 25281/23 të datës 09.06.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë, përmes emailit ankesa.kpmsnck@rks-gov.net, më datë 04.07.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.904/2023 me numër protokolli 5003/2023, me pretendimet ankimore se nuk ka pranuar njoftimin për intervistë me gojë dhe nuk qëndron fare pretendimi i këtij komisioni se pala është njoftuar -për intervistë me gojë; Në këtë procedurë testi me shkrim është mbajtur dy herë për shkak të problemeve ndërsa në testin e dytë nuk jemi nënshkruar me arsyetimin se na than që lista e parë mbetet e njëjtë me të dytën; Kandidatja fituese përvojën e punës e ka si edukatore në ciklin e ulët.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.07.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Vushtrrisë. Ndërsa, Këshilli më datë 11.07.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5003/2023 të datës 04.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi për ankuesen; Njoftimin e datës 29.05.2023 për ankuesen nga SIMBNJ; Njoftimin për testim me shkrim i datës 11.05.2023 nga J.S për ankuesen; Njoftimin e datës 19.05.2023 për ritestim nga J.S për ankuesen; Njoftimin e datës 31.05.2023 nga SIMBNJ për ankuesen; Vendimin me numër protokolli 25281/23 të datës 09.06.2023 të Komisionit të

Pranimet në Komunën e Vushtrrisë; Ankesën e datës 01.06.2023 të ankueses; Vendimin me Nr. 19722/23 i datës 08.05.2023; Ankesën e datës 05.05.2023 nga ankuesja; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 05.11.2013 deri 30.04.2023; Vërtetimin e datës 19.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë 06.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 11.07.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00011261 për grupin Specialit të Psikologjisë për pozitën *Zyrtar për Çështje Psikologjike*; Vendimin me Nr. 553/23 i datës 08.05.2023 për formimin e Komisionit të Pranimet; Njoftimin e datës 19.05.2023 për kandidatët për ritestim me shkrim; Lista e aplikantëve; Njoftimin për verifikimin përfundimtar të datës 08.05.2023; Lista e kandidatëve që janë nënshtruar testit me shkrim; Njoftim për probleme në testin me shkrim të datës 16.06.2023 nga J.S; Kërkesë urgjente e datës 17.05.2023; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 31.05.2023; Njoftimin për rezultatet e vlerësimit i datës 01.06.2023; Njoftimin për rezultatet përfundimtare të vlerësimit i datës 09.06.2023; testin me shkrim; Aplikacionin e ankueses i datës 25.04.2023, Diplomën e datës 11.06.2007, Diplomën me Nr. 2459, Certifikatën e datës 23.01.2016, 04.12.2016, 30.04.2017, 23.11.2017, 06.12.2017, 15.02.2018, Certifikatën Licencimi e datës 23.03.2018, 02.06.2021, Certifikatën për periudhën 13-15.12.2021, Certifikatën e datës 12.07.2017, Certifikatën e datës 22.12.2015, 05.03.2017, 12.10.2015, Certifikatën e vitit 2013, Certifikatën e datës 17.11.2013, 14.12.2013, 26.06.2013, Certifikatën e datës 23.02.2014, Certifikatën licencimi i datës 30.06.2014, Certifikatën e datës 21.06.2014, 10.09.2014, 13.12.2013, 06.12.2014, 11.07.2015, Vërtetimin e datës 22.01.2014, Vërtetimin e datës 19.03.2021, Referencë e datës 08.05.2018, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 30.03.2023; CV-në; Aplikacionin e kandidatët E.Sh i datës 15.04.2023, Diplomën me Nr. 3097, Diplomën me Nr. 3766/22, Certifikatën shtator 2021, Certifikatë Licencimi e datës 18.03.2201, Vërtetimin e datës 24.09.2020, letër rekomandimin e datës 16.03.2021, Kontratë Pune për detyra specifike e datës 31.08.2021, Certifikatën 2018, Certifikatën e datës 21.11.2017, Vërtetim nga Shkolla Fillore "Mustaf Venhari", Diplomë e datës 19.03.2014,, 29.07.2013, Certifikatën për periudhën 05.03.2013-17.05.2013, Certifikatën për periudhën 20.07.2004 deri 20.09.2004, Diplomën e datës 30.07.2014, Pëlqim i datës 19.01.2018, Dokument identifikimi i kandidates E.Sh, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 12.04.2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.08.2002 deri 02.05.2023, Vërtetimin nga SHPK te Duli, Kontratë punë për kohë të caktuar/pacaktuar e datës 01.06.2014, 01.03.2019; Aplikacionin e kandidates A.K, Diplomën me Nr. 7210, Certifikatën e Notave e datës 16.11.2020, Certifikatën e datës 24.06.2022, Certifikatën Nr. 20032022/2, Certifikatën me Nr. 2602022/3; Certifikatën me Nr. 30012022/4, Certifikatën maj-qershor 2022, Certifikatën e datës 28.04.2021, Certifikatën e datës 28.12.2021, Kontratë pune për punë dhe detyra të caktuar e datës 09.08.2022; Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit e datës 01.11.2022; Letër reference e datës 07.03.2023, Vërtetim i datës 28.06.2021, Letër reference e datës 16.06.2021, Pasqyra e llogarisë nga Trusti për periudhën 24.04.2022 deri 24.04.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 24.04.2023; Aplikacionin e kandidates L.B, Diplomën me Nr. 5052, Certifikatën me Nr. 26032022/24, Certifikatën me Nr. 27032022/20, Kontratë për praktikë e datës 01.03.2016, Vërtetim i datës 20.12.2022, Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 23.07.2019, 05.12.2018, Kontratë punë për kohë të caktuar e datës 02.03.2019, Kontratë punë për punë dhe detyra specifike e datës 31.08.2021, Vërtetim i datës 19.04.2023, Dokument identifikim, Letër rekomandimin e datës 30.05.2017, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 03.04.2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 21.01.2010 deri 02.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstaton se pretendimet e ankueses, janë të **pabazuara, sepse:**

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 25281/23 të datës 09.06.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë, pretendon se nuk ka pranuar njoftimin për intervistë me gojë dhe nuk qëndron fare pretendimi i këtij komisioni se pala është njoftuar-për intervistë me gojë; Në këtë procedurë testi me shkrim është mbajtur dy herë për shkak të problemeve ndërsa në testin e dytë nuk jemi nënshkruar me arsyetimin se na than që lista e parë mbetet e njëjtë me të dytën; Kandidatja fituese përvojën e punës e ka si edukatore në ciklin e ulët.

Nga provat e lëndës, respektivisht në bazë të konkursit me Nr. Reference: RN00011261 për grupin Specialist të Psikologjisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" si kërkesa të përgjithshme formale janë paraparë: "Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Kualifikime të posaçme formale: Baçelor i Psikologjisë me të paktën 180 ECTS; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës". Ndërsa në pikën 8 të konkursit tek Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve është paraparë: Testimi me shkrim, Vlerësimi i biografisë dhe intervistë.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se nuk ka pranuar njoftimin për intervistë me gojë dhe nuk qëndron fare pretendimi i këtij komisioni se pala është njoftuar-për intervistë me gojë, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, konstaton se pas mbajtjes së testit me shkrim, Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit dhe si rezultat i vlerësimit ankuesja është vlerësuar në testin me shkrim me 42 pikë ndërsa në fazën e jetëshkrimit me 20 pikë, që rrjedh se ka marr 62 pikë të mjaftueshme për të ju nënshtruar fazës së intervistës me gojë. Kështu pas vlerësimit të jetëshkrimit ankuesja më datë 29.05.2023 në orën 11:17 është njoftuar nga SIMBNJ për kalimin e kësaj faze ndërsa njoftimi përmban: "Vlerësimi i CV për shpalljen RN00011261 është përfunduar. Në bazë të vlerësimit nga ana e komisioni ju keni marr 20 pikë. Në bazë të pragut të përcaktuar në rregullore (16/2020) ju kaloni në fazën tjetër të vlerësimit të kandidatëve. Për më shumë informata vizitoni: <https://konkursi.rks-gov.net/my-applications/76761> 31.05.2023 (e mërkurë), ora 10:00 Salla e rekrutimeve nr. 16, kati I, Qendra e Kulturës, "Hasan Prishtina" Vushtrri".

Rrjedhimisht, duke ju referuar pikës 8 të konkursit të lartcekur si dhe njoftimit të datës 29.05.2023 për ankuesen përmes të cilit thuhet se keni kaluar në fazën tjetër të vlerësimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankueses i është dërguar njoftimi për fazën tjetër të procedurës pasi që ankuesja është dashur që të qaset në linkun e dërguar së bashku me emailin e datës 29.05.2023, si rezultat i kësaj i njëjti njoftim sikurse për ankuesen është dërguar edhe për kandidatët e tjerë e të cilët sipas këtij njoftimi kanë marr pjesë në intervistë me gojë, si rezultat i kësaj ankuesja është njoftuar përmes procedurave për fazën tjetër të procedurës pas vlerësimit të fazës së jetëshkrimit dhe ankuesja por edhe kandidatët e tjerë me konkurs kanë qenë të njoftuar se në cilat faza bëhet vlerësimi i kandidatëve kjo e përcaktuar edhe me nenin

16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "2. Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë" dhe nenin 23 paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje, i cili përcakton se: "1. Pas vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë", kështu që ankuesja ka plotësuar kushtet për të vazhduar në fazën e intervistës, ndërsa Kolegji i Këshillit, pas konstatimit si më lartë vlerëson se ankueses nuk i janë cenuar të drejtat për intervistë me gojë sikurse as kandidatëve të tjerë, dhe për rrjedhojë njoftimi i datës 29.05.2023 është bërë në pajtim të plotë me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me numër protokolli 25281/23 i datës 09.06.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Vushtrrisë është në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si rrjedhojë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se në këtë procedurë testi me shkrim është mbajtur dy herë për shkak për shkak të problemeve ndërsa në testin e dytë nuk jemi nënshkruar me arsyetimin se na than që lista e parë mbetet e njëjtë me të dytën, Kolegji i Këshillit, konstaton se fillimisht testi me shkrim është caktuar të mbahet më datë 16.05.2023 dhe në të janë paraqitur katër kandidatë, mirëpo gjatë kësaj faze njërit prej kandidatëve u janë paraqitur probleme në kompjuter kjo dëshmohet edhe sipas emailit të datës 16.05.2023 të dërguar për Zyrtarët e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke e bashkangjitur edhe problemin që është shkaktuar, ku sipas kësaj informate kandidates që i'u janë shfaqur problemet në testim nuk kanë mundur t'i vazhdojnë minutazhin prej 15 minutash dhe pasi që kjo nuk ka qenë e mundur atëherë edhe sistemi për të përfunduar procesin me shkrim nuk kishte qasje kjo është arsyetuar edhe nga ana e Komunës së Vushtrrisë respektivisht Njësisë së Burimeve Njerëzore. Pas kësaj kandidatët më datë 19.05.2023 janë njoftuar që ritestimi do të mbahet më datë 23.05.2023 nga ora 15:00, dhe për rrjedhojë më këtë datë në ritestim janë paraqitur të gjithë kandidatët e ftuar dhe të cilët sipas dëshmisë janë nënshkruar tek formulari i listës së aplikantëve pasi që të njëjtit janë nënshkruar edhe më datë 16.05.2023. Marr për bazë konstatimin si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë testi me shkrim i datës 16.05.2023 nuk ka qenë i mundur të përfundohet si proces, atëherë mbajtja e testit me shkrim për herë të dytë konkretisht më datë 23.05.2023 për të gjithë kandidatët nuk është cenim i parimit të meritës dhe i procesit të pranimit, ngase kjo procedurë ka qenë për të gjithë kandidatët njëjtë dhe nuk ka pasur dallime në këtë çështje, kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuar ngase, janë respektuar parimet e përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të përcaktuara me nenin 6 dhe parimet e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht të përcaktuara me nenin 6.

Kolegji i Këshillit, sa i përket pretendimit ankimor të ankueses se kandidatja fituese përvojën e punës e ka si edukatore në ciklin e ulët, konstaton se nga aplikacioni i kandidates fituese shihet se e njëjta për nga përgatitja profesionale posedon Diplomën me Nr. 3097 të datës 06.02.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se më datë 27.12.2013 ka përfunduar studimet themelore në Departamentin e Psikologjisë duke marr titullin "Bachelor i Psikologjisë", sa i përket përvojës së punës posedon Vërtetimin me Nr. 42632/20 të datës 24.09.2020 të lëshuar nga Njësia e Personelit e Komunës së Vushtrrisë me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën në Qendrën për Punë Sociale në Vushtri, posedon Kontratë për punë dhe Detyra Specifike të datës 31.08.2021 me të cilën dëshmohet se nga data 01.09.2021 deri më datës 31.12.2021 ka qenë e angazhuar si Psikologe në Komunën e Vushtrrisë, sipas Vërtetimit të lëshuar nga Shkolla Fillore "Mustafë Venhari" në Vushtri dëshmohet se nga data 10.01.2018 deri më datë 24.06.2022 ka qenë duke punuar si asistente me fëmijët me nevoja të veçanta, sipas Kontratës për punë për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 01.06.2014 dëshmohet se nga data 01.06.2014 deri më datë 01.12.2014 ka punuar si Edukatore në NSH Kopshti Dielloni në Vushtri, si rezultati i kësaj kjo kandidate ka plotësuar kërkesat e përgjithshëm formale të kërkuar me këtë konkurs dhe për këtë pozitë.

Në kuptim të dispozitave e ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprime procedurale që përbejnë tërësinë e procesit të pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00011261 për grupin Specialit të Psikologjisë për pozitën "Zyrtar për Çështje Psikologjike" dhe si rrjedhojë nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale dhe materiale të cilat në esencë do ta bënin si të paligjshme këtë procedurë të pranimit, andaj mbi bazën e këtij konstatimi Kolegji konstaton se pranimi në këtë procedurë është bërë në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publike, i cili përcakton se: "1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve", nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë".

Andaj bazuar në at që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.904/2023, datë 17/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.